



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 18985 Prot.

Lezhë, më 28.12.2023

VENDIM

Nr. 84, Datë 27. 12. 2023

“PËR
EMËRTIMIN E SHKOLLËS 9-VJEÇARE PLLANË ME EMRIN “NDUE SMAÇI”

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nënpika 1.7, shkronja “b”, nenit 54, shkronja “ll” dhe nenit 55, pika 2 dhe 6 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, nenit 3, të ligjit nr. 9270, datë 29.07.2004, “Për sistemin e adresave”, të ndryshuar, ligjit nr. 69/2012, datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe pas depozitimit të firmave nga më shumë se 250 zgjedhës të Fshatit Pllanë, me propozim të Kryesisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë;

Vendosi :

1. Shkollës 9-vjeçare publike “Pllanë”, me vendndodhje në Fshatin Pllanë, Njësinë Administrative Zejmen, Bashkia Lezhë, t’i jepet emri: Shkolla 9-vjeçarë publike “NDUE SMAÇI” Pllanë.
2. Çdo vendim i mëparshëm që bie në kundërshtim me pikën 1, të këtij vendimi, shfuqizohet.
3. Ngarkohet Kryetari Bashkisë Lezhë për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI
NDUE LULI

Në mungesë dhe me autorizim
ZV/KRYETARI
AGOSTIN MARKU



10B

Prot 18585//

Dt 0.1.24.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT LEZHË
SEKTORI JURIDIK

Nr. 1067/14 Prot.

Lezhë, më 03.01.2024

Lënda: Konfirmim vendimi

KËSHILLIT TË BASHKISË LEZHË

Për Dijeni : KRYETARIT TË BASHKISË LEZHË

Bazuar në nenin 16 pika 2 gërma "b" të ligjit Nr. 107/2016, datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", nenin 54 shkronja "II" të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" të ndryshuar, konfirmoj bazueshmërinë ligjore të vendimit nr. 84, datë 27.12.2023 të Këshillit të Bashkisë Lezhë "Për emërtimin e shkollës 9-të vjecare Pllanë me emrin "Ndue Smaçi".

P R E F E K T I

Gjergj PRENDI

